Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
Nr.: 945/26
Data: 06.11.26

Prishtinë, 23 tetor 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3430_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në,

- Nenin 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 26, Nenin 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenin 6 dhe 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Nenin 5, 6 dhe 7 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.ZRRE/Nr.07/2017);
- Aplikacionin për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, dorëzuar në Rregullator me datë 3 korrik 2026 nga Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A, me adresë në Sheshi Bill Klinton Nr.13 (lokacioni i HC Ujmani në Zubin Potok), 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
- VENDIMIN Nr.:26/5919/MMPH dt. 16.10.2026, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për suspendim të përkoshëm për periudhë një (1) vjeçare të aplikimit të normave dhe cilësisë së mjedsit në rastin e aplikimit të NH Ibër-Lepenc SH.A, HC Ujmani dhe
- VENDIMIN Nr.: 5911/26-ZSP-ARPL, dt.16.10.2026 PËR LËSHIMIN E LEJES UJORE TË PËRKOHSHME për operimin e Hidrocentralit "UJMANI" (Gazivoda), të NH Ibër Lepenc Sh.A.

në seancën e mbajtur me datë 23 tetor 2026, nxori këtë:

V E N D I M

I. **I LËSHOHET LICENCA** për prodhim të energjisë elektrike (nga uji) Ndërmarrjes Hidroekonomike Ibër Lepenc Sh.A (NUI 811280015) – **HC UJMANI,** me numër licence **ZRRE/Li_122/26,** sipas Vendimeve të MMPH me numër Nr.:26/5919/MMPH dt. 16.10.2026 dhe Nr.: 5911/26-ZSP-ARPL, dt.16.10.2026, për periudhën nga **23 tetor 2026** deri **15 tetor 2027,** me mundësi vazhdimi të licencës, nëse i licencuari aplikon jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës.

II. **OBLIGOHET** N.H Ibër Lepenc- HC UJMANI që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të këtij vendimi të sigurojë Lejet përkatëse (për ujë dhe mjedis) dhe kopjet e të njëjtave t'i dërgojë në Rregullator, njëkohësisht të informoj Rregullatorin mbi masat e marra për sigurimin e këtyre leje nga Ministria përkatëse.

III. **OBLIGOHET** N.H Ibër Lepenc- HC UJMANI të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për N.H Ibër Lepenc, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

IV. **OBLIGOHET** N.H Ibër Lepenc- të përmbush kushtet e licencës të specifikuara në licencën numër ZRRE/Li_122/26.

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 3 korrik 2026 ka pranuar Kërkesën për Vazhdim Licence për prodhim të energjisë elektrike të N.H Ibër Lepenc – HC Ujmani.

- Sipas Nenit 32 paragrafi 3 të ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kohëzgjatja e licencës mund të zgjatet/vazhdohet nëse i licencuari parashtron kërkesë me shkrim për vazhdim licene, jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës. Në këtë rast, aplikacioni i N.H Ibër Lepenc nuk konsiderohet vazhdim licence, pasi që kërkesa për vazhdim licence nuk është bërë brenda këtij afati.

- N.H Ibër Lepenc ka dorëzuar Aplikacioni me dokumentacionin përkatës për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HC Ujmani, në pajtim me Nenin 8 dhe 9 të rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

- Licenca e lëshuar për N.H Ibër Lepenc për HC Ujmani me 4 tetor 2006 (Nr. i Licencës ERO/Li_17/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_17/12), e modifikuar 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_17/17), ka vazhduar të mbetet e vlefshme për një periudhë prej njëzetë (20) vitesh, deri me 04 Tetor 2026.

- N.H Ibër Lepenc me rastin e aplikimit për licencim të prodhimit të energjisë elektrike, nuk ka dorëzuar Lejen Ujore si dhe Lejen Mjedisore të Integruar siç kërkohet me legjislacionin në fuqi, por për këtë çështje ka dorëzuar VENDIMIN Nr.:26/5919/MMPH dt. 16.10.2026 dhe VENDIMIN Nr.: 5911/26-ZSP-ARPL, të dt. 16.10.2026.

- Sa i përket VENDIMIT Nr.:26/5919/MMPH të dt. 16.10.2026 të lëshuar nga MMPH për Leje Mjedisore, përveç tjerash thuhet:
  - *Suspendohet përkohësisht për periudhë **një (1) vjeçare** aplikimi i normave dhe cilësisë së mjedisit në rastin e aplikimit të N.H Ibër Lepenc (HC Ujmani).*
  - *MMPH ka pranuar dhe është duke e shqyrtuar kërkesën e N.H Ibër Lepenc për dhënien e Lejes Mjedisore, sipas Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.*
  - *Duke u nisur nga fakti se N.H Ibër Lepenc është ndërmarrje me interes vital për Kosovën, MMPH do ta mbështes me një Njoftim të praktikuar deri më tani, për kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për ta vazhduar licencën në ZRRE.*
  - *Pasi që zbatimi i dispozitave që dalin nga ligji i lartëcekur kërkojnë analizë të thellë të gjendjes teknike të instalimeve të N.H Ibër Lepenc Sh.A – HC Ujmani, që paraqesin një kompleks të madh industrial, por edhe me një vjetërsi të konsiderueshme do të kërkohet një bashkëpunim i ngushtë me N.H Ibër Lepenc për të planifikuar përmbushjen e standardeve të përcaktuara me legjislacionin për mjedis.*
  - *Pas shqyrtimit të aplikacioni për t'u pajisur me Leje Mjedisore (e cila është në procedurë) dhe pas plotësimit të kushteve sipas Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore, MMPH do të lëshojë vendimin për leje mjedisore.*

- Sa i përket VENDIMIT Nr.: 5911/26-ZSP-ARPL të dt. 16.10.2026 të lëshuar nga MMPH për Leje Ujore, përveç tjerash thuhet:
  - *Aprovohet kërkesa e N.H Ibër Lepenc dhe lëshohet Leja Ujore e Përkohshme për shfrytëzimin e resurseve ujore të akumulimit të Liqenit të Ujmanit (Gazivodës) për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike në Hidrocentralin e Ujmanit.*
  - *caktohet kjo Leje Ujore për një afat të përkohshëm prej **dy (2) vitesh**, duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij vendimi (pra nga 16 tetor 2026 deri 16 tetor 2028).*
  - *përcaktohen parametrat maksimal teknik dhe hidro-energjetik të lejuar për operim me fuqi të instaluar të Hidrocentralit 35 MW e ndarë në dy agregate gjeneruese me nga 17.5MW.*

Suspendohet përkohësisht për periudhë një (1) vjeçare aplikimi i normave dhe cilësisë së mjedisit në rastin e aplikimit të N.H Ibër Lepenc (HC Ujmani).

- Vlen të theksohet se me 4 tetor 2026 N.H Ibër Lepenc- HC Ujmani i kishte skaduar afati i licencës për operim prej kur edhe është ndërprerë operimi nga ky Hidrocentral deri në datën e lëshimit të kësaj licence.

- Licenca e lëshuar për N.H Ibër Lepenc për HC Ujmani me 4 tetor 2006 (Nr. i Licencës ERO/Li_17/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_17/12), e modifikuar 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_17/17), tani e lëshuar me numër licence **ZRRE/Li_122/26** do të jetë e vlefshme sipas pikës I. të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6)** muaj para skadimit të afatit të licencës si dhe është në pajtim me plotësimin e kushteve të licencës nr.ZRRE/Li_122/16 të datës 23.10.2026, të lëshuar nga Rregullatori.

- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës dhe dëshmive të bashkangjitura sipas aplikacionit për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike të dorëzuar nga N.H Ibër Lepenc ka vlerësuar ato dhe ka ka konsideruar se janë plotësuar dëshmitë relavante për lëshimin e licencës, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Driton Gojani, Kryesues

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Vendimi iu dërgohet:
- N.H Ibër Lepenc – HC UJMANI
- Arkivit të ZRRE-së